



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: contact@pallatirinise.com

www.pallatirinise.com

Në bazë të dispozitave të nenit 10, paragrafit 10.5 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies me qira të hapësirave kulturore, sportive dhe ekonomike dhe kontrata e shtëpisë, e datës 22.06.2023, pas identifikimit të Departamentit të Administratës për hapësirat e lira dhe bazuar në Vendimin e datës 05.09.2025 të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, me datë 05.09.2025, publikohet kjo:

FTESË PËR OFERTË

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
- Personat fizik dhe juridik (për depo),
të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.
Hapësirat e destinuar për persona juridik – hapësira afariste:

	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m ²
1.	Lok. Nr. 032	18 m	18.80 € Neto
2.	Lok. Nr. 033	18 m	18.80 € Neto
3.	Lok. Nr. 051	425 m ²	12.50 € Neto
4.	Lok. Nr. 077	33 m ²	18.17 € Neto
5.	Lok. Nr. 090	423 m	12.17 € Neto
6.	Lok. Nr. 096	27 m ²	18.17 € Neto
7.	Zyre (Ish Qendra e mjekësisë sportive dhe rekreacionit)	400 m ²	15.00 € Neto
8.	Zyre nr. 116/6 (që ndodhet në pjesën e hollit në mes të dy sallave, niveli i sheshit, pjesa perëndimore e Sallës Universale të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë)	48 m ²	7.50 € Neto
9.	Depo nr. 02 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)	54 m2	6.17 € Neto
10.	Depo nr. 04 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)	70 m2	6.17 € Neto
11.	Depo nr. 05 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)	60 m2	6.17 € Neto
12.	Garazha që ndodhet në Parkingun e Qendrës	65.52 m ²	6.17 € Neto
10.	DEPOT E SPORTIT		
11.	Depo (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të Sportit)	83.85 m ²	6.17 € Neto
12.	Depo e ish Sigurimit (në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)	28 m ²	6.17 € Neto

15.	Depo e sportit ne korridorin aier trim kabineit	15 m	0.1 / e neto
-----	---	------	--------------

Vërejtje:

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
2. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
3. Oferta financiare – çmimi për m² (pa TVSH);
4. Të dhënat e arkës fiskale;
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Fletëpagesa e aplikimit.

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m²;
2. Tarifa e aplikimit është 200,00 €, e cila paguhet në xhirollogari: 1708020600000056

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur terhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë 15.09.2025, deri në ora 12:00 në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve, 10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më 15.09.2025, në ora 12:10, në zyrat e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga 05.09.2025 deri më 15.09.2025, çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00, duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: contact@pallatirinese.com
- Në uebfaqen zyrtare: www.pallatirinese.com
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.